



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0843**

Paneli Shqyrtues, duke vendosur në përbërje nga, Isa Hasani-kryetar, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) lidhur me ankesën e OE Pro Acc Group SH.P.K., ushtruar kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rivleresimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH “Iber Lepenc” Sh.a.” me nr. të prokurimit: "IL-24-8711-2-2-1", iniciuar nga Ndermarrja Hidroekonomike Iber Lepenc SH.A., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), më 07.10.2024, mori:

## **Vendim**

1. **Aprovohet pajtimi i palëve**, për ankesën e OE "Pro Acc Group SH.P.K", me nr. 2024/0843, e datës 13.09.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rivleresimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH “Iber Lepenc” Sh.a.” me nr. të prokurimit: "IL-24-8711-2-2-1", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ndermarrja Hidroekonomike, Iber Lepenc SH.A.
2. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

Me 22.08.2024, Ndermarrja Hidroekonomike Iber Lepenc SH.A., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për Kontratë (NJK) dhe dosjen e tenderit (DT), për aktivitetin e prokurimit “Rivleresimi i Aseteve në Ndërmarrjen Publike NH “Iber Lepenc” Sh.a.” me nr. të prokurimit: "IL-24-8711-2-2-1".

Me 05.09.2024 OE Pro Acc Group SH.P.K., nga cilësia e tij/sajë si palë e pakënaqur me vendimin e cituar ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar me Vendimin e AK të datës 05.09.2024. Kurse, me 13.09.2024 OE Pro Acc Group SH.P.K., ka ushtruar ankesë në OSHP, kundër vendimit të cituar si më sipër të AK, e cila është evidentuar me numër të protokollit 0843/2024.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrijë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 28.09.2024, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar.
- AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Konstatohet paraprakisht se, raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Në këtë rast evidentohet se të dyja palët (AK dhe OE) janë në dijeni lidhur me shkresat komplete të kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores për Punën e OSHP dhe se të dyja palët kanë deklaruar në sistemin elektronik AK me 04.10.2024 si dhe OE me datën 01.10.2024 se pajtohen me rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli konsideron se procedura e shqyrtimit përfundon në këtë fazë, në kuptim të pajtimit (marrëveshjes) së arritur të palëve dhe rrjedhimisht e njëjta ka humbur pretendimin, respektivisht objektin ankimor sikurse kërkohet shprehimisht me dispozitën e nenit 111, të LPP. Me rastin e shqyrtimit të shkresave të kësaj lënde, natyrës dhe qëllimit të sajë, Paneli shqyrtues konsideron se palët mund ti zgjidhin raportet eventualisht kontestuese mes vete në ato raste kur ato në saje të legjislacionit, disponojnë lirisht me të drejtat e tyre. Andaj, paneli shqyrtues nuk është lëshuar fare në vlerësim të pretendimeve ankimore por vetëm nxjerrë vendim për përfundimin e procedurës.

Pajtimi i arritur mes palëve nuk bije nësh me parimet bazë dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe nuk e atakon pavarësinë institucionale të AK saj, për të zgjidhur çështjen kontestuese, meqë e lejon natyra e çështjes në rastin konkret, mes tjerash konform nenit 19 paragrafi 4 të Rregullores së Punës së OSHP-së Nr. 01/2020 (e amandamentuar).

Paneli shqyrtues bazuar në faktin se OE ankues dhe AK, kane deklaruar pajtimin me Raportin e ekspertit shqyrtues, sipas të cilit është aprovuar ankesa e OE ankues, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Megjithatë, Paneli ju kujton palëve se në kuptim të nenit 19, paragrafi 4, të Rregullores për punën e OSHP parashihet se, *cituar*: “Në rast se autoriteti kontraktues dhe parashtruesi i ankesës pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues, paneli shqyrtues nxjerrë njoftim që autoriteti

kontraktues në afat prej 5 ditësh ta implementoj raportin e ekspertit shqyrtues duke i njoftuar palët në procedurë. Për më tepër informohen palët, që ky vendim ka karakter procedural për palët në procedurë dhe në rrethana të tilla të gjeturat e këtij raporti nuk i janë nënshtruar vlerësimit nga Paneli Shqyrtues.

Prandaj bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues ne pajtim me nenin 105, 116 dhe 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër Lepenc SH.A.**
- **OE - Pro Acc Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: